

Gëzuar Pashkët!



NGJALLJA

Nr. 4 (159) Viti XV i botimit

PRILL 2006

Çmimi 20 lekë



...Jeta del nga varri. Kërcen në fre-skinë e saj më të kulluar. Pse të kemi frikë? Ç'ka se kish qenë dimri. Lulet me nënqeshjen e tyre të ëmbël, me erën e tyre hyjnore, e shpuan përsëri tokën që t'u japin kurajë atyre që ndihen të lodhur, të japin premtime ndër të gjithë. Pse të rrimë të vretur si hipokritë? Do ta lëshonin vallë yjet dritën e tyre qiello-re përmbi ne, po të kishin të drejtë pesi-mistët? Kush është aq shpirtlig, aq mosmirënjohës, aq i ulët, aq i pazot, që të thotë se iu rëndua jeta? S'është fjala të jemi të lumtur a fatkeqë, të shëndoshë a të sëmurë, të rinj a pleq, të pasur a të varfër, por fjala është të kemi dashuri për jetën, besim në të, të jemi të gatshëm për të mirën.

Vetëm atëherë do të tregohemi të denjë të vetes sonë, të denjë të dashurisë

që tregoi Perëndia, i Cili për njeriun u bë njeri dhe derdhi gjakun e Tij të kulluar mbi Kryqin. Vetëm atëherë do ta ndiejmë gëzimin e Ngjalljes dhe mallëngjimin që na shkakton përshëndetja "Krishti u Ngjall!"

"Krishti u Ngjall!" është përshëndetja më e bukur që mund t'i drejtojmë njëri-tjetrit. Është trumbetimi më entuziast i jetës. Atyre që kemi në shtëpi, të sëmurëve, le t'u themi "Krishti u Ngjall!". Atyre që na duan dhe atyre që na urrejnë, le t'u themi "Krishti u Ngjall!", "Krishti u Ngjall!" le t'u themi dhe të vdekurve tanë. Më në fund, "Krishti u Ngjall!" le t'i thotë gjithsecili prej nesh vetes së tij dhe të gjithë bashkë le të këndojmë "Krishti u Ngjall!".

B.

Qendra Diagnostike Orthodhokse "Ungjillëzimi"

Përurohet skaneri më modern në Shqipëri

Ditën e shtunë, dt. 18 mars, në mesditë, në Qendrën Diagnostike Orthodhokse "Ungjillëzimi" në kryeqytet, u përrua skaneri tomografik më modern në Shqipëri dhe i dyti në Ballkan. Në vazhdim të kontributit të gjithanshëm që jep për shoqërinë shqiptare, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë fut teknologjinë më të fundit në mjekësi. Ky skaner i ri, i pari në vend dhe i dyti në Ballkan, me vlerë një milion euro, do të kontribuojë për shëndetin e popullatës.

Në përrurim morën pjesë ministri i Shëndetësisë z. Maksim Cíkuli, ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta z. Kosta Barka, ish - ministri i Shëndetësisë z. L. Solis,

ambasadori i Greqisë z. Pandelis Karkabasis, zv/ambasadori i Rusisë, diplomatë, personalitete të shkencës e mjekësisë, si dhe përfaqësuesi për Ballkanin i kom-

(vijon në faqen 3)



Bordi drejtues dhe besimtarët e Kishës Orthodhokse Shqiptaro-Amerikane të Shën Trinisë në Boston, e pritën me gëzim dhe krenari zgjedhjen e Kryepiskopit +Anastas si President i Këshillit Botëror të Kishave.

Përfaqësuesit e 348 kishave Kristiane nga 120 vende të botës, të mbledhura në Porto Alegre të Brazilit, me të drejtë i dhanë votën Kryepiskopit +Anastas, i cili e ngriti nga zeroja Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, të shkatërruar përfundimisht nga regjimi komunist, duke i rritur prestigjin dhe vendosur në një radhë me kishat e tjera Kristiane të botës.

Duke e uruar Kryepiskopin +Anastas, i cili gjithmonë rrezaton mirësi, zgjuarsi, dashuri, shpresë, tolerancë e mirëkuptim me të gjithë, i lutemi Zotit tonë Jisu Krisht t' i dhurojë shëndet të plotë në detyrën aq fisnike e Hyjnore për konsolidimin e kishave Kristiane në gjithë botën dhe në veçanti të Kishës sonë Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Bordi Drejtues dhe besimtarët orthodhoksë të Kishës Shqiptaro-Amerikane të Shën Trinisë në Boston USA.

Tiranë

Kremtohet Ungjillëzimi i Hyjlindëses



Më 25 mars, në kishën katedrale "Ungjillëzimi i Perëndilindëses", në kryeqytet, u festua Ungjillëzimi i së Tërëshenjtës Mari. Liturgjia u krye nga Kryepiskopi Anastas, i ndihmuar nga Hirësia e Tij Ilia dhe klerikë të tjerë. Kryepiskopi u bëri thirrje besimtarëve t' i përgjigjen "Vullnetit të Perëndisë sikurse bëri edhe Shën Maria kur ishte vajzë e re".

Studentët e Akademisë Teologjike, turne për prezantimin e shkollës

Prezantimi i parë u bë në dioqezën e Tiranës e më pas turneu do të vazhdojë në dioqezat e Beratit, Gjirokastrës dhe Korçës.

Studentët e Akademisë Teologjike "Ngjallja e Krishtit" kanë nisur një turne nëpër dioqezat e Kishës sonë për të prezantuar shkollën dhe punën e saj në përgatitjen e kuadrove të rinj.

Me iniciativën e tyre dhe mbështetjen e Dekanit të Akademisë, Hirësi Ilia Ketrit, studentët e vitit të katërt do të udhëtojnë në disa qytete të vendit për t' u takuar me të rinjtë e enorive të ndryshme, për t' u shprehur atyre dobinë dhe përjetimet nga jeta në akademi. Qëllimi kryesor është që të afrojnë sa më shumë rininë shqiptare në jetën më Krishtin si dhe për t' u bërë një ftesë për të ndjekur studimet në këtë shkollë.

Programi i këtij aktiviteti përmban një paraqitje me fotografi të historisë së krijimit të akademisë,



momente nga jeta në shkollë, psalme të kënduara nga vetë studentët dhe një vend të veçantë zë edhe dëshmia e çdo studenti për mënyrën sesi vendosi të ndiqte studimet në këtë shkollë dhe çfarë ka përfituar prej saj.

Studentët janë të pasur në shpirtitrat e tyre kur shkojnë në akademi dhe pasurohen më shumë gjatë viteve atje me ecurinë e tyre në mësim, por pikë së pari në ecurinë e tyre

shpirtërore duke përjetuar jetën shpirtërore në adhurim, lutje, në përqëndrimin e tyre në dialog me Krishtin të cilën e bëjnë në një mënyrë fisnike, por që ushqehet në jetën e tyre familjare të akademisë. Gjithashtu rriten në marrëdhëniet e tyre shoqërore nëpër dioqezat e ndryshme të Shqipërisë për të predikuar, për katekizëm, për të marrë pjesë në drejtimin e jetës së enorive të tyre, të dërguar si apostujt për

të ringjallur orthodhoksinë në Shqipëri.

"Misioni i këtij projekti të akademisë është t' u bëjë një thirrje të rinjve për të marrë në konsideratë të ardhmen. Dhe kur mendohet për të ardhmen, është mirë që të rinjtë të marrin në konsideratë Kishën dhe akademinë tonë. Ata janë të ftuar gjithmonë të na bëjnë një vizitë, të njihen me jetën tonë që me shpresë të bëhet edhe jeta e tyre, të kenë marrëdhënie miqësore me studentët e akademisë, të diskutojnë dhe të luten"- tha Hirësi Ilia.

Shumë prej studentëve të akademisë, djem dhe vajza, kanë pranuar thirrjen e Zotit të shërbejnë si klerikë, pjesëtarë të tjerë në kor dhe në shërbime të tjera të Kishës duke dhënë kështu një ikonë të plotë që Akademia Teologjike "Ngjallja e Krishtit" arrin qëllimin e saj të shenjtë.

Isidor Koti

Përurohet skaneri më modern në Shqipëri

(vijon nga faqja 1)

panisë amerikane General Electric, prodhim i të cilit është skaneri. Në fillim u krye shërbesa e Ajazmës dhe Përrimit.

Më pas, në fjalën përshëndetëse, drejtori shkencor prof. dr. Thoma Kristo falënderoi Kryepiskopin Anastas për iniciativën morale dhe materiale në sjelljen e këtij skaneri dhe në çeljen e kësaj qendre, për të ndihmuar të sëmurët që vijnë nga të gjitha zonat e Shqipërisë në Qendrën Diagnostike të Kishës Orthodhokse. *“Pajisjet e shumta që janë sjellë - shtoi ai, - vazhdojnë ta pasurojnë edhe më shumë qendrën me aparatura, laboratorë e mjete të tjera, duke pasur mundësinë për përcaktimin e një diagnoze të saktë, të shpejtë dhe bashkëkohore”.*

Pajisja me këtë skaner u realizua me iniciativën dhe përkujdesjen e Kryepiskopit Anastas dhe me bashkëpunimin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, të dy organizatave joqeveritare greke (të

Qendrës Ndërorthodhokse “Porefthendes”, Athinë dhe të Human Net, Rrjeti Evropian i Zhvillimit Humanitar, Janinë) si dhe u financua 75% nga Shërbimi i Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (YDHAS), i Ministrisë së Jashtme të Greqisë. Përpjekja nisi para 5 vjetësh (në kohën e ish-zëvendësministrit të jashtëm z. A. Lovrdhos) dhe përfundoi me kontributin e madh të zëvendësministrit të jashtëm të Greqisë, z. E. Stilianidhi.

“Dua të theksoj se, për të arritur deri këtu kishte nevojë për këmbëngulje dhe përpjekje të madhe. Ky do të jetë një mjet shumë i rëndësishëm për Qendrën Diagnostike Orthodhokse që t’i shërbejë mbarë popullit. Ne urojmë që gjithsecili, kudo që të ndodhet, të rre-



Çast nga shërbesa e Ajazmës

zatojë këtë dashuri dhe shpresë” - tha Kryepiskopi Anastas duke falënderuar edhe donatorët që ndihmuan në realizimin e këtij projekti.

Në fund të aktivitetit, të ftuarit panë nga afër funksionimin e skanerit, si dhe morën pjesë në kokteil.

Korresp. i Gazetës “Ngjallja”

“Dhuratë për mbarë shoqërinë”

- Nga përshëndetja e Kryepiskopit Anastas në përrimin e skanerit -

Ky aparat do të jetë një mjet tepër i vyer, për klinikën këtu, që do t’i shërbejë mbarë popullit. Përdorimi i kësaj aparature duhet të bëhet me durim dhe duke vazhduar zinxhirin e dashurisë që e solli deri këtu. Duhet të tregohet dhembshuri për çdo person, për çdo njeri, pavarësisht se çfarë gjendje shoqërore ka, apo se në çfarë komuniteti bën pjesë. Kjo pajisje nuk është diçka që nuk ka shpirt, aparaturë pa shpirt. Ajo lidhet me besim në lidhje me përdorimin, ka shumë shpresë brenda vetes dhe shumë dashuri. Shpresojmë që do të jetë një transmetues, përcjellës i këtyre tri gjërave që përmendëm jo vetëm këtu në kryeqytet, por në mbarë shoqërinë e vendit. Shoqëria jonë është në një fazë të progresit dhe

(vijon në faqen 4)

Skaneri (ose Tomografia e kompjuterizuar), është i tipit spiral, multidetektor, me 32 prerje në një rrotullim dhe është një hap i ndjeshëm përpara edhe në raport me skanerat e mëparshëm multidetektor. Ai karakterizohet nga një shpejtësi tepër e lartë e ekzaminimit, sidomos krahasuar me aparatet që janë në përdorim në vendin tonë, gjë që e bën të përshtatshëm jo vetëm për ekzaminimet konvencionale, por edhe të atyre të enëve të gjakut.

Meqenëse ky aparat realizon ekzaminimin me një shpejtësi të lartë, mund të përfundojë me një frymëmbajtje të vetme ekzaminimin e toraxit apo të abdomenit. Gjithashtu, për këtë arsye mund të përdoret një dozë e vetme kontrasti për të ekzaminuar dy pjesë të trupit njëkohësisht. Skanimi i zemrës mund të kryhet në 12-15 sekonda. Ky skaner arrin rezolucione të larta dhe mund të realizojë imazhe 3-dimensionale në një kohë të shkurtër dhe me cilësi. Ky aparat do të përdoret nga një personel me kualifikim të posaçëm jashtë vendit. Skaneri i blerë për Qendrën Diagnostike është prodhim i kompanisë ameri-

Të dhëna për skanerin



kane General Electric, Light Speed Pro32.

Të dhëna për Qendrën Diagnostike:

Qendra Diagnostike Orthodhokse “Ungjillëzimi” në Rugën e Dibrës, është hapur në vitin 1999, duke qenë ndër më bashkëkohoret dhe më konkureset me simotrat e saj në vend dhe në rajon. Kjo qendër është një nga më modernet në Shqipëri dhe në të ekzistojnë kabine të ndryshme, si i Fizioterapisë, Reumatologjisë (i pajisur me aparatet e teknologjisë së fundit dhe të vetmin e këtij lloji në Shqipëri për matjen e densitetit kockor), Radiologjisë, Kardiologjisë (provë ushqimore, holteri, Echo, Ekg etj), Neurologji, Psikiatri, Kirurgji, Gjinekologji, Pediatri si dhe laboratorët: klinik, biokimik, mikrobiologjik, cito-histo-patologjik dhe ai dentar, të cilët u vijnë në ndihmë mijëra pacientëve. Shërbimi u ofrohet të gjithë njerëzve pa dallim besimi. Qendra është me karakter jofitimprurës. Pajisjet e reja.

“Dhuratë për mbarë shoqërinë”

(Vijon nga faqja 3)

të ngritjes dhe çdo hap pozitiv që kryhet nga çdo lloj grupimi shoqëror është një dhuratë për mbarë shoqërinë shqiptare.

Falënderojmë të gjithë ju, se në personin tuaj dhe në sytë tuaj ne shohim që kemi miq e mbështetës për këtë përpjekje dhe ne urojmë gjithsecilin në fushën ku ai punon që të rrezatojë këtë të vërtetë, këtë dashuri dhe këtë shpresë.

Kryepiskopi Anastas iu drejtua të pranishmëve edhe pas prerjes së shiritit të përirimit:

Po lë për në fund diçka, që si zakonisht vjen si shumë zyrtare në traditën tonë orthodhokse. Të gjitha aparaturat më të përsosura që kemi sjellë, po nuk patëm njerëzit e aftë që t'i përdorin ato, nuk bëhet asnjë gjë. Unë dua të shpreh mirënjohjen time për grupin e zgjedhur të mjekëve që punon në këtë qendër.



Mjekë të Qendrës Diagnostike Orthodhokse gjatë ceremonisë së përirimit

Ajo që në fakt përbën dallimin nuk janë mundësitë teknike që ofrohen këtu, edhe sikur të themi që jemi përpjekur dhe kemi gjetur aparaturat më të mira. Ajo që përbën diferencën është njohja e thellë

mjekësore që ekziston në këtë qendër, dhembshuria dhe respekti për çdo person që vjen në të, kushdoqoftë, i njohur ose i panjohur. Duam t'i falënderojmë në mënyrë të nxehtë këta njerëz për atë çka ofrojnë.

“Dua të shpreh mirënjohjen time për grupin e zgjedhur të mjekëve që punon në këtë qendër. Ajo që përbën diferencën është njohja e thellë mjekësore që ekziston në këtë qendër, dhembshuria dhe respekti për çdo person që vjen në të, kushdoqoftë, i njohur ose i panjohur. Mendojmë se kjo përbën ndryshimin për të ardhmen në Shqipëri të këtyre shërbimeve”

Mendojmë se kjo përbën ndryshimin për të ardhmen në Shqipëri të këtyre shërbimeve. Na duhet më shumë dituri, më shumë cilësi e më shumë dashuri në këto shërbime.

Korresp. i gazetës “Ngjallja”

Komuna e Çarshovës, në rrethin e Përmetit, është një nga trevat më të lashta të zonës Përmet - Ersekë, e banuar nga një popullsi autoktone e besimit të krishterë orthodhoks në mbi 90%. Kjo trevë përbëhet nga 9 fshatra ekzistues si dhe nga 8 fshatra të braktisur në vite, për të cilët flasin sot rrënojat e tyre.

Historia e lashtë e këtyre fshatrave të besimit orthodhoks dëshmohet nga prania e 48 kishave.

Është karakteristike se çdo fshat ka pasur më shumë se tri kisha, përjashtuar fshatin e Çarshovës me 13 kisha dhe 3 manastire.

Të dhënat historike si dhe ato të kodikëve kishtarë, të cilat kanë ekzistuar deri në vitet 1944-1948, tregojnë qartë ndërtimet e para në shek. IX-X në kohën e sundimit sllav në këto treva. Kjo dëshmohet edhe nga emrat sllavë të ngjelur edhe sot si: kisha e Borodicës, Sadova, Radova, Martenica etj.

Më vonë, në shek XIII - XVII ndërtimi i kishave u shtua shumë në saje të investimeve të vetë fshatarëve si dhe emigrantëve të shumtë që ka pasur kjo zonë.

Në vitin 1804 u ndërtua kisha e Shën Marisë në qendër të fshatit Çarshovë me përkujdesjen e Vasiliqisë, zonjës së Ali pashë Tepelenës, një nga kishat e rralla të zonës Përmet - Leskovik.

Ajo ka një sipërfaqe prej 120m² me 9 kube

E shkuara dhe e sotmja

të pikturuara dhe gjithë pajisjet e tjera të një kishe moderne të stilit grek.

Më 1931, Theodor Vangjeli, emigrant në Amerikë, ndërtoi kishën e Shën Kristoforit.

Sot, nga 48 kisha janë vetëm 8 të rikonstruktuar si dhe një e re, kisha e Shën Kozmait në qendër të fshatit, e inaguruar në vitin 2000.

Gjatë viteve 1908-1915 u shkatërruan shumë kisha si dhe dy manastiret e vjetra, gjatë sundimit xhonturk dhe Luftës së Parë Botërore.

Në vitin 1959 janë gjetur shumë materiale, si kryqe, gurë të gdhendur me shenjtorë, pjesë ikonash, themele të këtyre kishave, etj... të cilat

u grumbulluan nga prifti i fshatit Koço Haxhi dhe iu dorëzuan muzeumit të Përmetit.

Po kështu gjatë viteve 1938-1945 u shkatërruan shumë kisha të tjera. Mbas vitit 1967, me mbylljen e kishave, në vendin tonë u bë një shkatërrim total jo vetëm i besimit, por edhe i të gjitha objekteve fetare, duke prishur e djegur ikonat, ikonostaset, librat kishtarë etj. Një pjesë e madhe e këtyre kishave u kthyen në stalla, depo plehu apo reparte ushtarake.

Mbas viteve 90 - të rilindi përsëri besimi. Me ardhjen e Kryepiskopit të parë pas shumë vitesh ateizmi, Fortlumturisë së Tij, Anastasit, Kisha Shqiptare u gjallërua përsëri. Në çdo fshat u rindërtuan kisha si ajo e Shën Kozmait në fshatin e Çarshovës.

Epitrop Gjergji Haxhi

Kryepiskopi i ftuar në simpoziumin për filozofinë greke

Në datat 6-7 prill, Shoqata Shqiptare e Filozofisë Greke organizoi në mjediset e Hotel “Tirana”, një simpozium kushtuar rolit të kësaj filozofie në historinë botërore, deri në ditët tona. Në këtë veprimtari, ku referuan shkencëtarë të njohur shqiptarë dhe grekë, ishte i ftuar nderi dhe mori pjesë edhe Kryepiskopi Anastas.

Vizitë në Kryepiskopatë e këngëtares së njohur

Në datën 10 prill, Kryepiskopi Anastas priti në Kryepiskopatën e Hirshme, në Tiranë, me kërkesën e saj, këngëtares shumë të njohur greke Ana Visi, pjesëtarë të grupit të saj etj. Ajo kishte ardhur në Shqipëri me rastin e një shfaqjeje artistike të organizuar nga TV “Klan”.

Ikonat t'i shërbejnë komunitetit që i ka krijuar

- Vazhdojnë veprimet autonome të institucioneve shtetërore, që bien ndesh me ligjin për trashëgiminë kulturore -

Duke u nisur nga shkrimet e ditëve të fundit për restaurimin dhe ekspozimin e 83 ikonave nga fondi i Muzeut të Artit Mesjetar të Korçës, në Selanik të Greqisë, i rikthehem një problemi që, për fat të keq, në vijueshmëri na shfaqet me fytyra të ndryshme: ai i pronësisë së ikonave të magazinuara në institucionet tona të kulturës.

Për të qartësuar lexuesin, po kujtojmë historinë e ikonave, të cilat pak kohë më parë iu kaluan padrejtësisht nga një urdhër absurd i Ministrisë së Kulturës për kalimin një numri ikonash nga fondi i Institutit të Monumenteve të Kulturës, fondit të Muzeut Kombëtar.


Ne na duhet të sqarojmë se ikonat, për të cilat bëhet fjalë, janë tërhequr nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (si dhe nga institucione të tjera) nga kishat e shpallura monumente kulturore, por edhe nga kisha të tjera, me qëllim mbrojtjeje dhe ruajtjeje nga grabitjet dhe dëmtimet e ndryshme që ato mund të pësonin në kushtet e vështira dhe të pasigurta që ka kaluar vendi ynë, si dhe nga gjendja jo e përshtatshme e shumë prej tyre. Një pjesë tjetër janë tërhequr nga institucionet e kulturës edhe për qëllime studimi e restaurimi. Në çdo rast, ky veprim është konsideruar provizor, me qëllim që në të ardhmen, me krijimin e kushteve të përshtatshme, ato të rikthehen në objektet e kultit prej nga janë marrë.

Në ligjin për trashëgiminë kulturore, i cili është miratuar në vitin 2003, janë të qarta nenet dhe nënenet, dhe se si vepron në raste specifike dhe të zakonshme me objektet e trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme.

Në rastin e ekspozimit dhe të restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore ligji i përcakton saktësisht procedurat për këtë veprim dhe më saktë, neni 19, pika 3, thotë: "Lëvizja e objektit të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare dhe unike për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Proce-

durat e këtyre lëvizjeve përcaktohen me udhëzimet e Këshillit të Ministrave, sipas konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për këtë qëllim. Në çdo rast leja e lëshuar regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore."

Pra, duke u mbështetur në nenin e mësipërm, kemi të drejtë të kërkojmë se si janë ekspozuar dhe restauruar ikonat e sipërpërme-



*Krishti Pantokrator
- Mendohet të jetë pikuruar nga
Onufri rreth shek. XVI.
Ndodhet në Muzeun Kombëtar
të Artit Mesjetar, në Korçë.*

ndura kur në një nga gazetat e përditshme drejtori i muzeut thotë: "Unë si drejtor, po ashtu edhe vetë stafi i muzeut, duke parë këtë interesim, vendosëm që ikonat e restauruara të ekspozohen."

Për ndërhyrjen dhe restaurimin e ikonave duhet të paraqiteshin paraprakisht projekte për konservimin e tyre sipas nenit 17, pika 5 dhe 6 që thotë: "Punimet e restaurimit, të cilat kryhen nga organizmat jashtë sistemit të institucioneve shtetërore, të ngarkuara për mbrojtjen, konservimin, restaurimin e studimin e tyre, mbikëqyrjen detyrimisht në këto institucione. Projektet e restaurimit në çdo rast paraqiten dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve."

Në shumë raste, duke u nisur edhe nga rasti i mësipërm, institucionet që merren me trashëgiminë kulturore nuk njohin ligjin dhe marrin vendime të nxituara dhe jashtë kompetencave të statusit të tyre.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm, i cili nuk është marrë parasysh, është koordinimi i marrëdhënieve me pronarin legjitim të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Në rastin tonë, ikonat dhe objektet e tjera kishtarë, siç dihet, janë

Ikonat dhe objektet e tjera kishtarë, siç dihet, janë pronë fizike dhe shpirtërore e Kishës dhe e Komunitetit Orthodhoks, të cilit i kanë shërbyer dhe i cili i ka porositur dhe financuar gjatë gjithë historisë së ndërtimit dhe dekorimit të objekteve të kultit.

Një monument kulture konsiderohet i tillë me të gjithë inventarin e objekteve dhe të dekoracioneve që ai përmban. Pra dhe ikonat janë pjesë e pandashme e monumentit dhe largimi e përdorimi i tyre në mënyrë të ndashme nga objekti ku janë marrë, do të çenonte rë-

pronë fizike dhe shpirtërore e Kishës dhe e komunitetit orthodhoks, të cilit i kanë shërbyer dhe i cili i ka porositur dhe financuar gjatë gjithë historisë së ndërtimit dhe dekorimit të objekteve të tyre të kultit. Në ligjin për trashëgiminë kulturore janë të përcaktuara qartë marrëdhëniet, të cilat rregullojnë raportet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe pronarit të objektit që përbën fond për trashëgiminë kulturore. Neni 16, pika 1 thotë: "Institucionet e specializuara shtetërore në marrëveshje me pronarët dhe zotëruesit e objekteve të trashëgimisë kulturore, krijojnë kushte për ekspozimin e këtyre objekteve për publikun." Kurse, në rastin e mësipërm, Kisha Orthodhokse

nuk ka as të paktën një njoftim të thjethhtë për veprimet dhe lëvizjet që janë bërë me 83 ikonat e restauruara dhe të ekspozuara tashmë.

Në kohën kur Kryeministri aktual i Shqipërisë premtion, për kthimin e pronave dhe të objekteve që historikisht i përkasin komuniteteve fetare në Shqipëri dhe që ka filluar të realizojë kthimin e tyre, duke përfshirë këtu dhe objekte monumente kulturore të cilat i përkasin trashëgimisë kulturore, ka edhe të tilla institucione, të cilat nuk dalin dot nga koraca e tyre shumëvjeçare dhe që vazhdojnë ta mbajnë veshin e shurdhër si ndaj zhvillimeve të marrëdhënieve ndërinstytucionale ashtu dhe ndaj ligjeve në fuqi, të cilat janë të detyruara t'i zbatojnë. Duke mos diskutuar aftësitë e tyre profesionale, dalim në konkluzionin që institucionet shtetërore nuk duhet të përdoren si institucione private dhe të pavarura, të cilat vetëvendosin në mënyrë të gabuar për çdo gjë që ato momentalisht zotërojnë në fondet e tyre, por duke bazuar ligjet të cilat janë rregullatorë të domosdoshëm, duhet të krijojnë hapësirë bashkëpunimi ndërinstytucional në mënyrë që të bëhet çka është më e mirë për objektet tona që janë përfaqësues të padiskutueshëm të trashëgimisë sonë kulturore.

Dhe në përfundim arrijmë të themi se një monument kulture konsiderohet i tillë me të gjithë inventarin e objekteve dhe të dekoracioneve që ai përmban. Pra, dhe ikonat janë pjesë e pandashme e monumentit dhe largimi e përdorimi i tyre në mënyrë të ndashme nga objekti ku janë marrë, do të çenonte rëndë vlerat për të cilat ato janë vënë në mbrojtje.

Funksionimi i natyrshëm i objekteve monument kulture është ai fillestar për të cilat ato janë të asamblluara të funksionojnë në mënyrë të tillë që t'i shërbejnë komunitetit i cili i ka krijuar.

Për Bërthamën e Trashëgimisë Kulturore
Ark. Restaurator
Gentian (Joan) Stratobërdha



Java e Madhe

Në Kishën Orthodhokse java e fundit e jetës së Krishtit quhet zyrtarisht **Java e Pësimit**. Në emërtimin popullor është quajtur **Java e Madhe**. Çdo ditë emërtohet në librat e shërbesave si “e madhe dhe e shenjtë”. Çdo ditë të javës ka shërbesa të veçanta, të cilat kryhen në të gjitha kishat. Jeta tokësore pushon për çdo besnik kur ata “shkojnë me Zotin në Jerusalem” (Mëngjesorja e të Hënës së Madhe).

Çdo ditë e Javës së Madhe ka temën e veçantë të saj. Tema e së Hënës është ajo e **drurit të fikut** që nuk kishte fruta, por vetëm gjethe dhe për këtë u dënua me tharje. Të Martën, theksi është në vigjilencën e **virgjërshave të ditura**, të cilat, jo si motrat e tyre të marra, ishin gati kur Zoti erdhi tek ato. Të Mërkurën, fokusi është në pendimin e **gruas mëkatore**. Në këtë ditë, theksohet shumë krahasimi ndërmjet gruas së përdalë që shpëtoi me anë të pendimit dhe Judës, që ishte një nga apostujt e zgjedhur, por që humbi nga pabesia dhe smira. Ajo i jep Krishtit gjithë pasurinë e saj dhe puth këmbët e Tij; ai me një puthje e tradhton Krishtin për para.

Në këto tri ditë këndohet Ungjilli gjatë Orëve dhe në Mbrëmësoret, kur shërbehet Mesha e Dhuratave të Parashenjtëruara. Këndimet nga Dhiata e Vjetër janë prej Eksodit, Jobit dhe Profetëve. Ungjilli është kënduar gjithashtu në Shërbesat e Mëngjesit, të cilat quhen tradicionalisht shërbesat e **“Dhëndrit”**, sepse tema e përgjithshme e secilës ditë është fundi i botës dhe gjyqi i Krishtit. Shërbesa e **Dhëndrit** kryhet natën. (Të mërkurën në mëngjes kryhet një shërbesë që përbehet nga: 1) Orët, 2) Mbrëmësorja dhe 3) Mesha e Dhuratave të Parashenjtëruara. Kjo është Mesha e fundit e Parashenjtëruar e kalendarit vjetor. Ndërsa natën, në vend të Shërbesës së Dhëndrit, të mërkurën kryhet Misteri i Efqlisë, si një përgatitje për marrjen e Kungatës të Enjten e Madhe, Dita e themelimit të Misterit të Kungatës së Shenjtë.)

Ja tek vjen dhëndri në mes të natës; dhe lum ai shërbëtor të cilin do e gjejë vigjilues dhe mjerë ai shërbëtor të cilin do e gjejë pa kujdes. Prandaj, o shpirti im, ki mendjen, se mos të rëndojë gjumi dhe jepesh në vdekje jashtë Mbretërisë; por zgjohu dhe thirr me zë të madh: I Shenjtë, i Shenjtë, i Shenjtë je Ti, o Perëndi, me lutjet e

Hyjlindëses mëshirë ki për ne (Tropari i Tri Ditëve të Para).

E Enjtja e Madhe i kushtohet Darkës Mistike që Krishti kremtoi me dymbëdhjetë apostujt e Tij. Tema kryesore e ditës është darka vetë, për të cilën Krishti porositi që Pashka e Dhiatës së Re të hahej në kujtim të Tij, të trupit të Tij që thyhet dhe gjakut të Tij, që derdhet për ndjesën e mëkateve. Gjithashtu, në shërbesat e kësaj dite kujtohet tradhtia e Judës dhe larja e këmbëve të nxënësve. Në kishat katedrale është zakoni që peshkopi bën larjen e këmbëve në një ceremoni të veçantë mbas meshës.

Ungjilli në Meshën Hyjnore përbehet nga një kombinim i të gjitha tregimeve të ungjillorëve për të njëjtën ngjarje. Himnet dhe leximet e ditës i referohen të njëjtit mister qendror.

Kur nxënësit me lavdi, në lanjëtoaren e darkës po ndriçoheshin, Juda i pabesë dhe tradhtar, nga argjenddashja u errësua nga lakmia dhe tek gjyqtarët e paligjshëm, të dorëzon Ty Gjykatësin e Drejtë. Ti që lakmon argjend shiko, se ky njeri prej lakmisë vari veten; largohu nga shpirti i pangopur që guxoi të tilla gjëra kundër Mësuesit. O Zot gjithmonë i mirë, lavdi më ty! (Përlëshorja).

Atje ku është Zoti, në Tryezën e Pavdekësisë, në vendin e lartë, me mendjet e ngritura lart, le të hamë me gëzim, o besnikë... (Kënga e nëntë e Kanonit të Mëngjesores).

Mesha Hyjnore e Shën Vasilit të Enjten e Madhe, kryhet bashkë me Shërbesën e Mbrëmjes. Ungjilli i gjatë i Darkës Mistike këndohet mbas këndimeve nga **Eksodi, Jobi** dhe **Isaia** dhe letrës së parë të Apostullit Pavël drejtuar **Korinthianëve** (Kapitulli 11). Himni i mëposhtëm zëvendëson Himnin Keruvik dhe gjithashtu, përdoret si himn gjatë dhe mbas kungimit.

Në Darkën tënde Mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar; se nuk do t’ua them armiqve të tu misterin; nuk do të të jap të puthur si Juda; por duke të pohuar si kusari, thërres: kujtomë, o Zot, në mbretërinë tënde.

Kremtimi liturgjik i Darkës së Zotit të Enjten e Madhe s’është thjesht një përkujtim vjetor i “themelimit” të misterit të Kungatës së Shenjtë. Ngjarja e Darkës së Pashkës nuk ishte thjesht veprimi i fundit i Zotit për “të themeluar” misterin qendror të besës së krishterë para pësimit dhe vdekjes së Tij. Por, përkundrazi, i gjithë misioni i Krishtit dhe para së gjithash, vetë qëllimi i krijimit të botës, është që krijesat e dashura të Perëndisë, bërë sipas shëmbëllesës dhe ngjashmërisë së Tij hyjnore, të mund të jenë përjetësisht në Kungimin më intim me Të, të ulur në tryezë me Të, duke ngrënë dhe duke pirë në mbretërinë e Tij të pambarim.

Kështu, Krishti, Biri i Perëndisë, flet tek apostujt e Tij gjatë darkës dhe tek të gjithë njerëzit që dëgjojnë fjalët e Tij dhe besojnë në Të dhe në Atin që E dërgoi:

Mos ki frikë, o tufë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqeu t’jua japë mbretërinë (Lluka 12:32).

Ju jeni ata që qëndruat me mua në sprovat e mia. Dhe unë ju caktoj mbretërinë ashtu si ma ka caktuar mua Ati im, që ju të hani e të pini në tryezën time, në mbretërinë time... (Lluka 22:28-30).

Prandaj, është e vërtetë të thuhet në një kuptim real, që trupi i thyer dhe gjaku i derdhur, për të cilat foli Krishti në darkën e Tij të fundit me nxënësit, nuk ishte thjesht një parabërje dhe një parashikim për atë që do të vinte; por ajo që do të vinte - kryqi, varri, ngjallja në ditën e tretë, ngjitja në qiell - ndodhën pikërisht që njerëzit të mund të bekoheshin nga Perëndia që të jenë në **Kungim të Shenjtë** me Të përgjithmonë, duke ngrënë dhe pirë në tryezën mistike të mbretërisë së Tij, që nuk do të ketë mbarim.

Kështu, **“Darka Mistike e Birit të Perëndisë”**, e cila kremtohet vazhdimisht në Meshën Hyjnore të Kishës së Krishterë, është thelbi i vërtetë i jetës pa mbarim, që do jetë në Mbretërinë e Perëndisë.

Lum kush do të hajë bukë në Mbretërinë e Perëndisë (Lluka 14:15).

Lum ata që janë ftuar në gostinë e Dasmës së Qengjit (Zbulesa 19:9).

Mesazhi i Pashkëve të para të kremtuara pas persekutimit, në vitin 1992

Në vend që të përshkruajmë errësirën, le të ndezim një llambadhë Pashke

†Anastasi

“Ku është, o Ferr fitorja jote? Krishti u ngjall dhe ti u mposhte.”

Ishte një epokë kur në këtë vend mbretëroi fryma e Ferrit. Një ateizëm i dhunshëm vriste ndërgegjet, mbyste çdo gjë me vlerë që ka jeta njerëzore: liri-në, besimin dhe dashurinë. Të fuqishmit e asaj kohe kërkuan të vrasin Perëndinë në zemrat e njerëzve, kryqëzuan përsëri Krishtin, jo vetëm për pak ditë, por për vite me radhë.

E varrosën Atë dhunshëm, jo vetëm për pak ditë, por për dekada. Dhe e vulosën varrin me gurin e rëndë të heshtjes së thellë. Dhe shpallën në formë panegjirike, me vendime kongresesh, se në Shqipëri vdiq Perëndia. Por atje ku të çmendur kërkuan të vrasin Perë-ndinë, shumë shpejt u zbulua se, përfundimisht ata vranë njeriun që është shëmbëlltyra e Perëndisë; dhe për më tej, shkrinë shoqërinë njerëzore, e cila nuk mund të jetojë pa Diellin e drejtësisë: Perëndinë. Ateizmi shkatërroi marrëdhë-niet individuale dhe shoqërore, u kallë frikën madje edhe lule-ve në ara, duke mbjellur në vend

U ngjall Krishti, dhe bashkë me Të u ngjallën liria, shpresa dhe gëzimi në shpirtrat e njerëzve. Pashka përbën kulmin e besimit kristian orthodhoks dhe Ngjallja gjendet në zemrën e spiritualitetit orthodhoks, në shpirtin e besimtarëve orthodhoksë.



Kisha “Ungjillëzimi i Hyjlindësës” në vitin 1991

kafkat e bunkerëve, duke e mbushur atë me varre të trishta, varre plot me frikë dhe me ankth.

Por kjo periudhë kaloi njëherë e mirë. “Krishti u ngjall së vdekurish, me vdekje vdekjen shkeli, edhe të varrosurve jetën u falë”. Ky marsh i orthodhoksëve përmbledh atë çka po ndodh sot në Shqipëri. U ngjall Krishti, dhe bashkë me Të u ngjallën liria, shpresa dhe gëzimi në shpirtrat e njerëzve. Pashka përbën kulmin e besimit kristian orthodhoks dhe

Ngjallja gjendet në zemrën e spiritualitetit orthodhoks, në shpirtin e besimtarëve orthodhoksë. Prandaj dhe porsa u lejua rikrijimi i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, me këtë mesazh filloi riorganizimi i saj. Të gjithë mbajnë mend sesi me fjalët “Krishti u ngjall!” në gojë udhëtuam nëpër qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë si i dërguar i Patrikanës Ekumenike të Konstandinopojës, të qendrës së orthodhoksisë sonë, e cila kujdeset për

(vijon në faqen 8)



Për çdo Pashkë, Kisha jonë na fton në një çlirim nga atmosfera e frikës dhe turbullimit, në fushën e shpresës dhe të paqes; nga padija, në të vërtetën e Perëndisë; nga errësira e mëkatit, në dritën e jetës më Krishtin; nga izolimi i egoizmit, në dashurinë aktive, në shoqërinë më Krishtin; nga ajo çka jemi, në atë që Krishti i ngjallur dëshiron të bëhemi: njerëz të Tij, që të bashkërendojmë vullnetin tonë me vullnetin e Tij.

Në vend që të përshkruajmë errësirën, le të ndezim një llambadhë Pashke

(vijon nga faqja 7)
besimtarët orthodhoksë në mbarë botën. Siguria e Ngjalljes mbush tani plot me dritë e fuqi zemrat tona dhe kënga e ngjalljes për dashurinë e shpresën jehon tani në qytetet, malet dhe luginat e këtij vendi dikur të kryqëzuar.

II

Me përshëndetjen gazmore "Krishti u ngjall!" e kremtojmë ne të krishterët Pashkën. Kjo fjalë përmbledh në vetvete kuptimin e thellë të Ngjalljes së Krishtit. Në Dhiatën e Vjetër fjala Pashkë ka kuptimin e daljes së popullit të Perëndisë nga robëria e Egjiptit drejt lirisë. Kisha e përdori këtë term për të shpallur Pashkën e re, të cilën e përuroi Krishti me Pësimin, Kryqin dhe Ngjalljen e Tij. Dhe me të Krishti vulosi Dhiatën e Re të dashurisë, duke udhëhequr popullin që do ta pasonte në një jetë të re të lirisë, të fitores përfundimtare mbi fuqitë e errësirës e të vdekjes. "Pashkë e Zotit, Pashkë" këndojmë "se prej vdekjes në jetë dhe prej dheut në qiell na shpuri Krishti, Perëndia ynë duke kënduar himne fitoreje".

Me Ngjalljen e Krishtit u krye një kalim i dyfishtë. Së pari, u plotësua kalimi i Perëndisë drejt njerëzimit, shpëtimi i gjinisë njerëzore, që nisi me Lindjen e Zotit tonë Jisu Krisht. Së dyti, me Ngjalljen bëhet i mundur edhe kalimi i njeriut drejt Perëndisë, drejt një udhe të re, që përfundimisht shpie në bashkimin me Të, në Hyjni-zimin e njeriut. Me Ngjalljen "lindi një jetë e re, një lloj i ri jetese, një ndryshim i vetë na-tyrës sonë". Mbi këtë siguri të Ngjalljes u mbështet

tërë be-simi, përvoja dhe dëshmia e Kishës sonë.

"Po të mos ngjallej Krishti, i kotë do të ishte besimi ynë". Gjinia njerëzore mund të ndeshet akoma me vdekjen dhe frymërat vdekjeprurëse të padrejtësisë, të urrejtjes, të mëka-

"U ndriçua gjithësia me Ngjalljen Tënde, o Krisht".

III

Për çdo Pashkë, Kisha jonë na fton në një çlirim nga atmosfera e frikës dhe turbullimit, në fushën e shpresës dhe të



Në vend që të përshkruajmë errësirën, le të ndezim një llambadhë Pashke. Llambadha e Pashkës simbolizon dritën që shkëlqen nga varri i boshatisur i Krishtit, dritën e shpresës dhe të fitores që shpërndan errësirën

tit, por vetë vdekja është e mundur njëherë e mirë, ajo është shkëlqim me vdekjen dhe me Ngjalljen e të Tërëfuqishmit, Zotit të gjithësisë, Jisu Krishtit. Dhe ai që bashkohet me Të, me anën e besimit, dashurisë dhe hirit të mistereve të Kishës së Trupit të Tij, do ta mundë edhe ai vdekjen dhe gjithçka lidhet me të dhe do të nxjerrë erën e keqe të saj. Ky është mesazi qe-ndror i ditës së sotme.

Sot "kremtojmë vdekjen e vdekjes, rrëzimin e ferrit, nisjen e një jete tjetër dhe himnojmë me ngazëllime shkaktarin". Akoma më gjerë: Krishti me Ngjalljen e Tij mori nga Perëndia Atë çdo pushtet, në qiell e mbi dhë", ripërtëriti gjithësinë. Dhe ne psalim sot:

paqes; nga padija, në të vërtetën e Perëndisë; nga errësira e mëkatit, në dritën e jetës me Krishtin; nga izolimi i egoizmit, në dashurinë aktive, në shoqërinë me Krishtin; nga ajo çka jemi, në atë që Krishti i ngjallur dëshiron të bëhemi: njerëz të Tij, që të bashkërendojmë vullnetin tonë me vullnetin e Tij. Me këtë kuptim, le t'i urojmë njëri-tjetrit: Gëzuar Pashkën!

Po veç kësaj, veçanërisht sivjet, bashkë me urimin e Ngjalljes: Gëzuar Pashkën, do të dëshiroja të shtoj një thirrje, e cila përmbledhet në shprehjen: Në vend që të përshkruajmë errësirën, le të ndezim një llambadhë Pashke. Llambadha e Pashkës simbolizon dritën që shkëlqen nga varri i boshatisur

i Krishtit, dritën e shpresës dhe të fitores që shpërndan errësirën. "Ejani, merrni Dritë prej Dritës që s'perëndon". Po, llambadha e Pashkës lidhet dhe me një dinamikë të posaçme. Drita e saj mund dhe duhet t'u jepet dhe llambadhave të tjera të afërta, të shuara, që të ndizen edhe ato. Dhe ka akoma shumë, që, për shkaqe të ndryshme, mbajnë shpirtin e tyre larg nga drita e besimit. Akoma ka shumë nga vëllezërit dhe motrat tona, me ndjenja të holla dhe tendenca fisnike, që mbeten në errësirën e padijes, sepse i mbajnë akoma të lidhur frymët vdekjeprurëse të propagandës ateiste të së kaluarës. Le t'i afrojmë të gjithë këta me respekt, me dashuri, dhe mirëdashje të sinqertë për të kremtuar së bashku këtë të kremte të madhe. "Le t'i ndiejmë të gjithë me rastin e Ngjalljes dhe kështu le të thërresim: Krishti u ngjall së vdekurish...".

Në vend që të mbetemi në errësirë, le të ndezim brenda nesh një llambadhë të Pashkës. Në vend që të përshkruajmë errësirën, le të ndezim një llambadhë për ata që kemi përrreth nesh, le të ndezim shumë llambadha Pashke në shoqërinë tonë, në mënyrë që edhe marshimi i ri përpara i popullit fisnik të Shqipërisë të bëhet një Pashkë e re gëzimi.

Me këtë triptik, të dashur vëllezër, le ta panagjerizojmë Pashkën e sivjetme. Përshëndetja jonë: Krishti u ngjall! Urimi ynë: Gëzuar Pashkën! Le të mbajmë parasysh gjithmonë: Në vend që të përshkruajmë errësirën, le të ndezim një llambadhë Pashke. Krishti u ngjall!

†Anastasi

15 vjet më parë në Tiranë

Liturgjia e parë Hyjnore në kishën e shndërruar në palestër

Prej disa muajsh kishin filluar përpjekjet për të rihapur kishën. Nga Shkodra e Berati vinin lajme të gëzuara se tempujt e Zotit po hapeshin. Këtu në Tiranë besimtarët orthodhoksë, me nismën e dhjak Spiro Findikut, të këshilluar nga i paharruari prof. Dhimitër Beduli, i cili ishte në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe nuk lëvizte dot, bënë përpjekje pranë pushtetit të atëherëshëm lokal për të na dorëzuar godinën e kishës të shndërruar në palestër sportive. Dhjak Spiroja së bashku me Nasi Hobdarin, që i përkasin familjeve të vjetra orthodhokse tiranase, shkolin pothuaj çdo ditë tek autoritetet për të marrë çelësat. U vendos që të bëhet një mbledhje me besimtarët e devotshëm, për të formuar një këshill drejtues provizor, që të kujdesej për të gjitha problemet pas marrjes në dorëzim të kishës. Kjo ishte caktuar të bëhej në shtëpinë e Lllazar Pjeshkazit, por, meqenëse numri i pjesëmarrësve ishte i madh, u vendos të bëhet në një nga sallat e Pallatit të Kulturës. Mbledhja u zhvillua ditën e hënë, më 4/2/1991. Pjesëmarrësit arritën në 38 veta, ku ishte i pranishëm atë Gaqo Petri, që dha bekimin dhe që pas shumë propozimesh u zgjodh Këshilli Provizor prej 7 vetash: atë Gaqo Petri, kryedhjakon Sotir Kanxheri, dhjakon Spiro Findiku, Petraç Rama, Dhimitër Beduli, Dhimitër Sinjari dhe Stavri Bojaxhiu. Ky këshill hartoi një projektplan për punimet që do të bëheshin. Gjysma e shkurtit dhe pothuaj gjithë marsi, vazhdoi me një punë intensive për ta sjellë kishën si më parë për kryerjen e meshave. Punët ishin të mëdha, mbasi kisha ishte në gjendje shumë të keqe. Për kryerjen e këtyre punimeve u aktivizuan



Çast nga një prej Liturgjive të para

me shumë zell: Nasi Hobdari, Lllazar Pjeshkazini, Spiro Vojo, Milto Mima, Todi Janku, Lek Tasi, Lllazar Nushi, Filip Nito, Petrika Shalësi, Spiro Bejleri, Taqo Kobuzi, Loni Kllapi, Thoma Valera, Pavlo Hobdari, Aleko Dhima, Minella Mihali, Vane Mazniku, Zoi Laska dhe shumë gra, si: Krisanthi Zoto, Luiza Stastoli, Florika dhe Drita Papajani, Tefta Kuqe, Elpiza Xhimitiku, Evanthi Manglara, Tefta Pite, Lirika Terezi, Zografo Nushi dhe shumë të tjera. Gjithashtu ndihmesë të çmuar ka dhënë dhe piktori prof. Gazmend Leka bashkë me nxënësit e tjerë Sokrat Sinani dhe Adrian Kapo në pikturimin e Kryqëzimit të Krishtit sikurse dhe shumë besimtarë në të holla, si: Krisanthi Zoto, Dhimitër Gjika, Ollga Karafili, Vasi Loli, Fiodor Prifti, Luiza Stastoli, Petraç Rroco, Gaqo Bushaka, Miti Theodhosi dhe sipas mundësive shumë e shumë të tjerë. Në mes të një gëzimi të madh dhe të një ma-

llëngjimi të përgjithshëm në datën 31 mars, ditën e diel u krye mesha duke u lajmëruar nga tingujt e kampanës. Kishte shumë të ftuar nga ambasadat dhe nga komunitetët e tjera fetare.

Fjalën e hapjes e mbajti i ndjeri z. Dhimitër Beduli dhe pastaj përshëndetën në emër të Trupit Diplomantik ambasadori rumun George Miku, në emër të Komunitetit Bekdashian z. Musa Mara dhe në emër të Komunitetit Mysliman z. Islam Kadesha. Pastaj filloi Mesha e Shenjtë që u krye nga atë Gaqo Petri me kryedhjakon Sotir Kanxheri dhe dhjak Spiro Findiku, kurse psaljet u kryen nga i ndjeri z. Dhimitër Beduli. Salla e kishës kishte një pamje që as mund të krahasohet

me atë të sotmen.

Dyshemeja e shtruar me pllaka të porsazbuluara nga parketi i vjetër që ishte shtruar sipër tyre. Kisha e përdorur si sallë gjimnastike nga Klubi Sportiv i Tiranës ishte keqpërdorur. Pluhuri dominonte nga të gjitha anët, muret ishin të palyera dhe të dëmtuara nga ganxhat prej hekuri të ngulura në to. Altari ishte i sheshuar dhe u ngrit duke përdorur si dysheme pjesë të parketit të ngritur me tulla. Gjithashtu dhe ikonostasi u ngrit me kuadrate të prerë të parketit 3x3 metra të ngritura në këmbë dhe të fiksuara me pajandime. Pastaj ikonostasin e veshëm me letër tapicerie të ngjitur me vinovil, mbi të cilin u vendosën ikona letre me korniza. Ishte një rast i veçantë filmimi me kamera nga Niko Hobdari. Pas 25 vjetësh Kisha jonë po ngjallej.

Besimtarët nuk rreshtnin së falënderuari Zotin dhe kudo shihje lot gëzimi. Sot, pas 15 vjetësh, shohim ndryshimin e madh të pakrahueshëm që ka pësuar kisha e Tiranës, me rikonstruksionin e saj të përgjithshëm dhe Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë në përgjithësi me punën e gjithanshme të rindërtimit anëmbanë Shqipërisë nën drejtimin dhe bekimin e Fortlumturisë së Tij Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Anastasit.

Nasi Hobdari

Berat - Kremtohet Ungjillëzimi dhe Adhurimi i Kryqit


Berati dhe në veçanti Kalaja, për numrin e faltoreve që ka, është si një kalendar të kremtosh, i jetuar dhe i respektuar. Janë jo pak, por 42 kisha - 42 shenjtore dhe të kremte. Pikërisht këtu në Kala, në një nga faltoret e saj, në Vangjelista, u kremtua Liturgjia e 25 Marsit, në prani të shumë besimtarëve. Atë e kreu atë Petraçi dhe dhjak Spiridhoni.

Të nesërmen, më 26 mars, në Kishën e Shën Spiridhonit u krem-

tua Adhurimi i Kryqit ose si i thonë ndryshe "dita e luleve". Që herët shumë besimtarë jo vetëm nga Gorica, por edhe nga Vakëfi, Mangalemi, Kalaja, Përroi filluan të mbushin kishën...

Liturgjia u krye nga atë Petraçi, i cili pasi drejtoi litaninë me stagonin plot me lule me kryqin në mes, iu dha besimtarëve që nderonin kryqin e shenjtë nga një lule.

Sotir Mishaxhiu



Pamje të brendshme të kishës së Ungjillëzimit, në vitin 1991 dhe sot.



Media, si e pasqyron realitetin fetar në Shqipëri

- Shkëputur nga kumtesa që u mbajt nga pedagogu i Akademisë Teologjike, **z. Vlash Plepi**, në një veprimtari me mediat dhe komunitetet fetare, organizuar nga USAID -

Sot, më shumë se kurrë, i jepet një theks i veçantë rëndësisë dhe ndikimit të mjeteve të informimit publik (mass-media) në formimin e personalitetit të njeriut. Pikërisht, kjo ndodh sepse sot, si asnjëherë, duke u stimuluar nga zhvillimi i teknologjisë, janë këto mjete informacioni, të cilat influencojnë masën e gjerë të popullit, influencojnë në formimin e imazhit tonë rreth qëndrimeve dhe ngjarjeve, duam apo s' duam ne, në mënyrë të ndërgjegjshme apo jo, influencojnë në sjelljen tonë, në ekzistencën tonë. Periudha e zymtë përgjatë një gjysmëshekulit prangosje, u përpoq të mbyste edhe belbëzimet ngashëruese të emrit të Zotit. Demagogjia e kuqe e komunizmit ateist mund të lejonte çdo lloj keqpërdorimi të fjalës për të përbaltur çdo gjë fetare, sikurse dhe çdo gjë tjetër, e cila ekspozonte vlera shpirtërore dhe që mund të zgjonte ndërgjegjen e pastër të njeriut. Pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj ishte trashëgimi i një mungese të mirëfilltë fetare, madje duke arritur deri aty sa dhe teologët të përballen sot me vështirësinë e risjelljes së shumë termave dhe shprehjeve nga leksiku i atëhershëm i gjuhës fetare shqipe, si dhe me risitë terminologjike sot.

Ka qëlluar jo pak herë që gazetarët të ngatërrojnë titujt e autoriteve fetare, duke mos njohur në të njëjtën kohë edhe strukturat institucionale. Kjo është normale, për shkak të mungesës së informacionit nëpër shkollë, por edhe në mungesë të jetës aktive në pasqyrimin e ngjarjeve fetare. Në të vërtetë nuk ekzistojnë në vendin tonë gazetarë të profilizuar për çështjet fetare. Realizimi i këtij misioni do të ishte i domosdoshëm edhe efektiv për të ardhmen. Por ajo që duhet të kemi parasysh, nuk është mbajtja mend e titujve kryesorë të autoriteteve fetare. E mira do të ishte që këta tituj të evidentoheshin herë pas here dhe të jepej edhe shpjegimi semantik i tyre. Në këtë mënyrë gazetari, por edhe publiku, do të kuptonte domethënien e termave të religjionit dhe të strukturave hierarkike të tij. Përshtypje të madhe më bëjnë disa

shkrime, që jo vetëm janë krejtësisht subjektive, por që tregojnë një mosnjohje elementare të realitetit të brendshëm të religjionit. Jo vetëm kaq, por arrijnë deri aty sa dhe të tregojnë mënyrën, që sipas tyre, duhet të funksionojë struktura e brendshme e tij....

Po t'i referohemi rregullave të gazetarisë, do të shikojmë që respektimi i tjetrit është kusht thelbësor për bashkëjetesën paqësore brenda komunitetit ku jetojmë dhe punojmë, brenda këtij morali të përgjithshëm, të cilin e predikon edhe feja kur thotë: "Duaje të afërmin tënd porsi vetveten" (Matt. 22:39), nëse bëjmë anatominë e realitetit

libri i parë i botuar në shtypshkronjën "Gutenberg", në vitin 1449, ishte Bibla.

Gjithkush është i lirë të shkruajë atë që mendon. Liria e fjalës dhe mendimit sanksionohet në kushtetutën e çdo vendi, ashtu sikundër vetë liria në konceptin e thellë të saj është një dhuratë e Perëndisë. Nuk po kapemi pas lajmit të raportuar, por pas një shkrimi që mban firmën e një individi me personalitet dhe njohje publike, që gëzon mbështetje dhe lexueshmëri. Në të vërtetë, çdo intelektual ka një njohje të përgjithshme në çdo sferë të jetës. Por momenti më delikat është kur ai merr përsipër të shfaqet në

Njohja e këtyre feve duhet të sjellë si rrjedhojë logjike të saj, veçanërisht për të gjitha llojet e mjeteve të informimit publik dhe të drejtuesve të tyre, respekt për komunitetet fetare dhe për figurat qendrore të tyre...

tonë shikojmë që jo pak herë cënohet me dashje liria e njeriut për të cilin shkruajmë. Ekziston një aksiomë e lirisë, e njohur nga të gjithë, që thotë: "Liria ime mbaron aty ku fillon liria e tjetrit". Duke evokuar Biblën Dejl Kernixh (Dale Carnegie), një orator shumë i suksesshëm në Amerikë, në fillim të shekullit të kaluar këshillonte: "Bëj për të tjerët atë që do të doje të bënin të tjerët për ty"....

Fetë në tërësinë e tyre shumëdimensionale kanë shërbesat praktikat, procesionet terminologjinë dhe shumë aspekte të tjera të njohura apo të panjohura. Prandaj, duhet respektuar dhe nuk duhet të konsiderohet i pavlefshëm ose arkaik fjalori fetar. Mënyra e të shprehurit ka rëndësi të veçantë, por siç thuhet edhe në gazetari: "Asgjë nuk ka vlerë, nëse nuk ka kuptim". Thelbësore është që të ekzistojë një frymë bashkëpunimi dhe jo amullie në përdorimin e termave. Nuk duhet të paragjykohet se dendësia e fjalëve në terminologjinë fetare krijon shpërqëndrim; përkundrazi, në predikime dhe në librat e shenjtë gjendet një fjalor i pasur dhe shumë i kuptueshëm. Jo më kot

rolin e një autoriteti, i cili mban përgjegjësi profesionale për ato që shkruan, pa qenë profesionist në fushën e caktuar, konkretisht për fenë. Duke mos qenë i tillë dhe duke mos pasur bagazhin e duhur, abstragon duke spekuluar ndoshta pa dashje me të vërteta të paqena, që qëndrojnë në nivelin e paragjykimit ose mentalitetit të krijuar brenda një suaze të caktuar njerëzish, duke u bërë pjesë e tyre dhe duke mos bërë diferencimin intelektual. Prandaj është i nevojshëm konsultimi shkencor, juridik, historik, por sidomos fetar, për të dhënë argumente të shëndosha dhe bindëse rreth çështjes së marrë në shqyrtim.

Kryepiskopi i Shqipërisë, Fortlumenturia e Tij, Imzot Anastasi, në librin e tij "Gjurmë nga kërkimi i trashëndentes" thotë se: "Njohja më e shumtë e feve të ndryshme nuk përbën tashmë komoditet të dijes, por parakusht për të kuptuar fenomenin kompleks fetar".

Duke parë zhvillimet e fundit të kontekstit fetar në botë, duket qartë se koha imponon domosdoshmërinë e njohjes së feve, në veçanti të atyre globale dhe të atyre që përbëjnë faktor të rëndësishëm në je-

tën e një vendi. Njohja e këtyre feve duhet të sjellë si rrjedhojë logjike të saj, veçanërisht për të gjitha llojet e mjeteve të informimit publik dhe të drejtuesve të tyre, respekt për komunitetet fetare dhe për figurat qendrore të këtyre feve...

*Akademia Teologjike
Orthodhokse, Shën Vlash, Durrës*

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, MAJ 2006

2 E Martë + Transf. i lipsanit të Shën Athanasit. Dësh. Esperit, Zoia etj.
5 E Premte + Dëshmg. Irini. Eftimi i Madhitës. Dësh. Gajani e Gai.
6 E Shtunë+ Jovi i Drejtë. Dësh. Mesiri, Therini, Danaksi.

7 E DIEL + E MIROPURËSEVE.

Kryqi që u shfaq në qiell. Dësh. Akaqi.
8 E Hënë + Ap. e Ungj. Joan Theologu. Osh. Arseni i Madh.
13 E Shtunë + Dëshg. Gliqeria. Omol. Sergji. Osh. Eftimi e Joani, gjeorgjianë.

14 E DIEL + E TË

PARALIZUARIT. Dësh. Isidhori. Hierod. Theraponti.
15 E Hënë + Osh. Pahomi i Madh. Akili i Larisës. Osh. Barbar mirovliiti.
17 E Mërkurë + #
Gjysmëpentikostia. Ap. Androniku e Junia nga të 70.
20 E Shtunë + Dësh. Thaleleu. Lidia në Filipe. Dësh. Asteri. Osh. Marku.

21 E DIEL + E SAMARITANES.

Konstandini dhe Elena. Borisi, mbreti bullgar.
22 E Hënë Etërit e Sin. II Ekumenik. Joan Vladimiri. (*Festohet më 4 qershor*)
25 E Enjte + Gjetja III e kokës së Joan Pagëzorit. Osh. Albani. Dësh. Celestini.
27 E Shtunë + Hierod. Heladhi. Omol. Joan rusi. Dësh. Efsevioti, Alipi.

28 E DIEL + E TË VERBRIT.

Hierodësh. Eftimi i Melitinës. Dëshg. Elikonida.
31 E Mërkurë + # **Mbyllja e Pashkës.** Dësh. Hermia. Petronila, bija e Ap. Petros.

Fal dhe do të jesh i falur

(Ligjëratë e mbajtur nga Joani i Pergamit para komunitetit të manastirit "Shën Joan Pagëzori", në Angli)

(vijon nga numri i kaluar)

Ja përse nuk mund të jemi të falur nga Perëndia nëse nuk mund të falim vëllanë tonë, i cili është tashmë i pranishëm atje ku Perëndia dëshiron të na vendosë. Çfarë të bëjmë në këto kushte? Si do mund të qëndrojmë atje? Nëse nuk pranojmë dhe nuk duam vëllanë tonë, ne nuk mund të gjejmë vend [me të] në Vendin e Perëndisë dhe për pasojë nuk mund të falemi prej Tij [d.m.th. të marrësh vend me Të] Ka shumë arsye për të cilat çelësi i Parajsës gjendet te falja e vëllait tonë. Pikë së pari, mëkatet që vëllai ka bërë kundër nesh, cilatdo qofshin ato, nuk krahasohen me mëkatet tona para Perëndisë. Ne i detyrohemi Perëndisë me miliona dhe Ai na dhuron përsëri. Dhe nga ana jonë, në qoftë se vëllai ynë na detyrohet disa monedha ne nuk ia falim. Ja një arsye e konsiderueshme! Ne nuk mund të presim që Perëndia të na falë numrin e madh të mëkateve tona kur ne nuk falim tek të tjerët disa gjëra të vogla. Ka një arsye edhe më të rëndësishme: Cilët jemi ne që gjejmë të tjerët? Shën Pavli u drejtohet Romakëve: "Kush je ti që gjykon shërbëtorin e tjetrit? Nëse mbahet më këmbë ose nëse bie, kjo i përket të zotit të tij. Po ai do të qëndrojë më këmbë, sepse Zoti ka fuqi ta forcojë" (Rom.14:4). Kush je ti pra të thuash se ky njeri është mëkatar? Ai ka gjykatësin e tij, zotin e tij, i cili e bën të mbahet më këmbë e mund ta falë. Kur marrim në duar gjykimin e tjetrit është si ta heqësh nga duart e Perëndisë këtë detyrë. Ja një arsye më tepër e cila tregon se falja është e domosdoshme. Për fat të mirë, asnjë nga ne nuk varet përfundimisht nga e kaluara e tij, por vetëm nga e ardhmja e tij. Nëse jemi të gjykuar në bazë të së ka-



luarës, do ishin të gjithë të dënuar. Përkundrazi, Perëndia na fal më Krishtin, duke na dhënë një të ardhme të re. Si rrjedhim, ne nuk kemi asnjë të drejtë të gjykojmë vëllanë tonë për të kaluarën, sepse është Perëndia që i jep të ardhme. Dhe ne nuk e dimë se këtë që po përjashtojmë sot nuk do të jetë një ditë një shenjtor, dikush që është penduar e i përket Mbretërisë së Qiejve. Ne nuk kemi të drejtë të themi cilin do pranojmë dhe cilin do hedhim poshtë. Nuk mund të përjashtojmë askënd, cilido qoftë ky, sepse Perëndia është i pasur në mëshirë e falje. Ai do të japë shlyerjen e mëkateve dhe do të marrë pranë Tij shumë nga armiqtë tanë. Dhe çfarë do të ndodhë atëherë me vëllezërit tanë? Si do jetojmë me ta në përjetësi? Do themi atëherë: "Përderisa i afërmi që ma punoi është këtu, unë nuk mund të rri me të në parajsë, do largohem pra! Si do të qëndrojmë pranë Perëndisë në përjetësi kur Ai e fali vëllanë tonë dhe ne ende nuk e kemi falur? Nuk është e mundur të jemi të

shpëtuar, as të bëjmë hapin e parë drejt Kreshmës së Madhe ose drejt pendimit nëse nuk falim tërësisht vëllanë, jo vetëm sentimentalisht, por në mënyrë që ta mbajmë brenda jetës sonë. Në të njëjtën mënyrë në gjirin e Kishës gjatë liturgjisë, Perëndia na afron të gjithëve me Vetën dhe na bën të qëndrojmë njëri pranë tjetrit, në të njëjtën mënyrë duhet edhe ne të hapim vend në shpirtat e në jetët tona që të bëjmë vend për të tërë njerëzit dhe në fillim për armiqtë. Shën Athanas Sinaiti na shkruan: "Ju lutem, vëllezërit e mi, largohuni prej mëkatit më të pafalshëm të mbajtjes së mërisë. Nëse doni të mësoni se errësira, e cila vjen nga mbajtja e mërisë në shpirt është mëkati më i keq. Çdo mëkat tjetër zgjat një çast ku ai kryhet dhe përfundon, ndërsa mbajtja e mërisë është një pasion që nuk rresht së djeguri. Atje ku ai ka zënë rrënjë, asgjë nuk përfiton; as kreshma, as përgjërimet, as pastërtia, as mëshira, asnjë e mirë tjetër, sepse mëria kundër vëllait shkatërron të gjitha gjërat. Shpesh

dëgjojmë të thuhet: "Mjerë unë, si do mund të shpëtoj? Nuk kam fuqi të kreshmoj, nuk mund të gdihem me lutje, nuk mund të ruaj dot gjatë gjithë jetës pastërtinë trupore, s'mund ta braktis botën, si do shpëtoj? Ja si të shpëtohesh: Fal dhe do të jesh i falur; ja udha që të çon drejt shpëtimit. Dhe do të tregoj një tjetër, cilën pra? Mos gjyko që të mos gjykoesh. Ai që gjykon para ardhjes së Krishtit është një 'antikrisht', sepse zë vendin e Krishtit. Shën Siluani e konsideronte faljen e vëllait dhe dashurinë për armiqtë si mrekullia më e madhe. Në fakt është një mrekulli. Është mrekullia që Perëndia kreu vetë duke na pranuar në krahët e Tij në mëkatarët. Dhe është e njëjta mrekulli që na fton të gjithëve ta kryejmë. Ja çfarë do të na gjykojë në fund, dashuria dhe veçanërisht dashuria për armiqtë, sepse të duash atë që të do është e thjeshtë dhe kjo do mund të ishte nga egoizmi ynë; të duash atë që të bën mirë është e natyreshme, nuk është një mrekulli, por të duash atë që të urren, ja mrekullia! Kisha, e cila është vendi ku ka vend për të gjithë, bëhet vend i zemrës sonë që vëllai ynë të gjejë vend brenda, çdo njeri dhe armiku ynë. Kështu, do jemi të aftë të kemi një vend në Mbretërinë e Perëndisë, mes krahëve të Tij, të cilat përqafojnë tërë armiqtë dhe mëkatarët. Në këto krahë të gjendemi të gjithë përjetësisht nëpërmjet hirit të Perëndisë.

Përktheu Elena Pani

**Adresat e faqeve në Internet dhe ajo
e E-mailit, të Kishës Orthodhokse Autoqefale të
Shqipërisë, janë:**

Internet: www.orthodoxalbania.org

E-mail: orthchal@orthodoxalbania.org



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

**Themelues: Kryepiskopi
Anastas**

**Del nën kujdesin e Këshillit
Botues**

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë

Tel: (042) 34-117, 35-095.

Fax: 32-109


Shtypur në shtypshkronjën
"Ngjallja"

Dje unë kryqëzohesha bashkë me Krishtin; sot unë lavdërohem bashkë me Të; dje unë vdiqa me Të; sot unë po kthehem në jetë me Të; dje unë u varrosa me të; sot unë po Ngjalle me Të. Por, le t'i sjellim fryte Atij i Cili pësoi e u ngjall për ne - ndoshta mund t'ju shkojë ndër mend se ju flas për ar ose argjend, ose pëlhurë të endur, ose gurë të çmuar të tejdukshëm, material që del nga toka e që mbetet këtu poshtë e në shumicën e rasteve gjithmonë posedohet nga njerëz të këqij, skllëvër të botës e të mbretërisë së errësirës së kësaj bote. Le të ofrojmë vetet tona, pronën më të shtrenjtë për Perëndinë dhe më familjare; le t'i japim sërish Shëmbëllimit atë çka është bërë sipas Shëmbëllimit. Le të njohim Autoritetin tonë; le të nderojmë Arke-tipin tonë; le të njohim fuqinë e Misterit dhe për cilin vdiq Krishti...

Le të bëhemi si Krishti, sepse edhe Krishti u bë si ne. Le të bëhemi Perëndi për Të, sepse edhe Ai u bë njeri për ne. Ai mori më të keqen, me qëllim që të na japë më të mirën; Ai u bë i varfër, me qëllim që nëpërmjet varfërisë së Tij ne të pasurohemi, Ai mori formën e shërbëtorit, që ne të fitojmë përsëri lirinë tonë; Zbriti që të lartësohemi; vuajti që të fitojmë; U çnderua që të lavdërojë; Vdiq që të shpëtojë; Ai u ngjiti në qiell që të na tërheqë pranë vetes edhe ne, që dergjemi poshtë në rënien e mëkatit. Le t'i japim të gjitha, le t'i japim fryte Atij i Cili e dha veten e Tij shpërblese e shkëmbim dhe nuk mund të japë asgjë kaq të madhe sa veten tonë, që ka kuptuar Misterin dhe është bërë për Të çdo gjë që Ai u bë për ne.

Shën Grigor Theologu

për Ngjalljen



E Diela e Dafinave

Hiri i Shpirtit të Shenjtë na mblodhi sot; edhe të gjithë e ngremë kryqin dhe themi: **I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit, hosana në më të lartat!**

(Vargu i Parë i Mbrëmësorës)

U varrosëm me pagëzimin bashkë me ty, o Krisht Perëndia ynë, u vlerësua për jetën pa vdekje me Ngjalljen tënde dhe të thërrasim me lavdi: **Hosana në më të lartat, i bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit!**

(Tropari i Dytë)

Në qiell si Mbret mbi fron, në dhenë si rob mbi pulisht, na je shfaqur, o Krisht Perëndi, prano lavdërimin e engjëjve dhe këngët e fëmijve që këndojnë: **I bekuar është ai që vjen të shpëtojë Adamin!**

(Shkurtorja)

Nga këndimet e të Shtunës së Madhe

“Ti, o Krisht, o jetë...”

Ti, o Krisht, o jetë, ti u vure në varr, edhe Forcat Engjëlllore çuditëshin, dhe lavdi këndonin për denjimin tënd.

Si po vdes, o jetë, si rri brenda në varr, kur pushtetin e armikut e shtype krejt, dhe prej Ferrit të varrosurit i ngjall.

Ty të madhështojmë, o Jisu Shpëtimtar, dhe nderojmë që të gjithë varrimin tënd, se prej vdekjes na shpëtove lavdërisht.

Ti që mate dhenë, o Jisu Kryembret, në një varr të vogël fare sot po banon, dhe të vdekurit prej varreve i ngre.

Krishti im i dashur, Mbret mbi qiell e mbi dhé, ç’do edhe ç’kërkon që zbritë në Ferr të zi? Mos do gjindjen njerëzore ta shpëtosh?

Zot’ i gjithësisë, si i vdekur u duk, dhe me vaje po vendoset në varr të ri, edhe varret prej të vdekurve i zbarz...

“Gjithë gjeneratat...”

Gjithë gjeneratat, vaje të blatojnë, o Krishti im, mbi varrin.

Arimathiani, të zbërthen prej Kryqit, dhe të varros me vaje.

Miropurëset erdhën, ta spërkatën varrin, me lot dhe me mira.

O Krijes’ e tërë, eja t’i blatojmë, vajtime Krijuesit.

Jetën si të vdekur, tok me Miropurëset, me lot le ta spërkatim.

O Josif i lumtur, shtjer në varr kufomën e Krishtit jetëdhënës...

Nga Kanoni i Epitafisë

Kënga VIII

Dridhu, tmerrohu ti, o qiell, edhe tronditu prej themelive ti, o dhé, se ja ku hidhet me të vdekurit, Zoti që lart mbretëron, dhe mbyllet në varrin e përunjur. O djema e bekonit, priftërinj e himnoni, të gjith’ e lartësoni përherë dhe për jetë. (2 herë)

Tmerri dishepujt i dërrmon, edhe lavdi fiton Arimathiani sot, se kur të vdekur dhe të zhveshur pa, Zotin Jisu Perëndi, e lyp dhe e varros duke thirrur: O djema e bekonit, priftërinj e himnoni, të gjith’ e lartësoni përherë dhe për jetë.

Ç’është çudia që shikoj! Ç’është kjo mirësi, ky durim që s’ka tregim! Duke dashur nënë dhé po hyn, Zoti që lart mbretëron, dhe shahet si Perëndi i rremë. O djema e bekonit, priftërinj e himnoni, të gjith’ e lartësoni përherë dhe për jetë.

Kënga IX

Mos më vajto ti, moj Nënë, kur më sheh të varrosur, Birin e dashur, që ke lindur virgjërisht, se do të ngrihem prapë dhe do të lavdërohem, dhe do t’i lartësoj si Perëndi, ata që të madhështojnë besërisht. (2 herë)

Kur të kam lindur pa dhembje, Bir i bashkëpanismë, jam lumëruar mbi çdo grua përmbi dhé; po kur të shoh të vdekur, o Zot dhe Bir i dashur, nga shpata e helmit çirrem tmerrërisht; po ngrehu prapë dhe më madhështo.

Zbrita në varr duke dashur, dhe u drodhën demonët, kur më panë të mbuluar plot me gjak, po do t’i shtroj armiqtë, do t’i godas me Kryqin, dhe do t’i dërmoj si Perëndi, dhe ngrihem prapë dhe të madhështoj.